



DATA/DATUM/DATE	05.04.2024
NR/ BR	07 Nr./ <u>454</u>
PËR/ZA/TO	Publikim të konkursit për edukator/e.
PËRMES/PREKO/THROUGH	Sektorit të administratës së Drejtorisë së Arsimit
NGA/OD/FROM	Drejtori i Drejtorisë së Arsimit z. Afrim Llabjani
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Konkurs për edukator/e.

Bazuar në nenin 08 të Ligjit të Punës 03/L-212, nenin 35 paragrafi 1,4 dhe 5 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr. 04/L-032, neni 5 pika c, i Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, nr. 05/2021, Normativi për Kuadrin e Arsimit të Përgjithshëm dhe të MASHTI-it, të Udhëzimit Administrativ me nr. 01/2024 i datës 05.03.2024, i MFPT, Drejtoria e Arsimit në Ferizaj shpall:

K O N K U R S

Për vende të lira të punës për edukator/e:

Numri i Pozitave: tetë (8)

Koeficienti: 5.2

Lloji i Pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik;

Titulli i mbikëqyrësit: Drejtori i institucionit;

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e zyrtarëve publikë

Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;

Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;

Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;

Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik.

Për vendin e punës për edukator/e kërkohet përgatitja përkatëse profesionale; **studime katërvjeçare të cilat barasvlerësohen me 240 ECTS**, sipas Udhëzimit Administrativ të MASHTI-it, nr. 05/2021, Normativi për Kuadrin e Arsimit të Përgjithshëm të MASHTI-it.

Të drejtë aplikimi kanë kandidatët me përgatitje profesionale përkatëse.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën për shërbimin e qytetarëve, për Drejtorinë e Arsimit.

Për aplikim kandidatët duhet të kompletojnë dokumentacionin në vijim:

Diplomën ose Çertifikatën e fakultetit, kopje e vërtetuar

Çertifikatën e lindjes, kopje

Kopjen e letërnjoftimit

Çertifikatën nga Gjykata që nuk është nën hetim (origjinali)

Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni.

Dokumentet e aplikimit nuk kthehen.

Aplikimi bëhet në formë elektronike në emailin adresën:

drejtoriaearsimit.ferizaj@gmail.com fillon nga data 05.04.2024- dhe mbyllet në ora 16-të 19.04.2024.

Rezultatet shpallen në tabelën e shpalljeve dhe në web faqen e komunës së Ferizajt, në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>.